Gjithashtu dhe mundësinë e dorëzimit të propozimeve lidhur me këto akte me shkrim në Zyrën e Kryetarit të Komunës, kati II dhe Zyrën e Drejtorisë së Financave, kati I, zyra e dytë, ana e djathtë. Propozimet dhe sugjerimet e të gjithë interesuarve janë mirëpritur **nga data 29.05.2026**, gjatë mbajtjes së dëgjimeve dhe **deri me datën 16.06.2026**.

TABELA E DETAJUAR E METODOLOGJISË SË DËGJIMEVE

Metodat e dëgjimeve	Data / Kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve	Ndarja sipas gjinisë	Numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime
Dëgjim Buxhetor në Sallën e Kuvendit, në Komunën e Klinës, me Kryetarët e Këshillave të Fshatrave.	Datë; 29.05.2026, Ora 10:00	0 Pjesëmarrës.	0 Burra, 0 Gra.	0 kërkesa apo sugjerime të regjistruara; 0 Pranohen, 0 Refuzohet,
Dëgjim Buxhetor në Oden e Fshatit, në fshatin Poterç i Epërm, më banorët e fshatrave Poterç i Epërm, Poterç i Poshtëm, Drenoc dhe Dugajevë.	Datë; 02.06.2026, Ora 17:00	17 Pjesëmarrës.	17 Burra, 0 Gra.	8 komente, kërkesa apo sugjerime të regjistruara; 8 Pranohen, 0 Refuzohen.
Dëgjim Buxhetor në SHFMU “Azem Bejta”, në fshatin Grabanicë, më banorët e fshatrave Grabanicë, Dollovë, Bokshiq, Këpuz dhe Qeskovë.	Datë; 02.06.2026, Ora 18:30	15 Pjesëmarrës.	15 Burra, 0 Gra.	0 komente, kërkesa apo sugjerime të regjistruara; 0 Pranohen, 0 Refuzohen.
Dëgjim Buxhetor në SHFMU “Motrat Qiriazit”, në fshatin	Datë; 04.06.2026, Ora 17:00	11 Pjesëmarrës.	11 Burra, 0 Gra.	6 komente, kërkesa apo sugjerime të regjistruara;

Zajm, më banorët e fshatrave Zajm, Gremnik, Deiq, Dollc dhe Dresnik.				5 Pranohen, 1 Refuzohet.
Dëgjim Buxhetor në SHFMU “Avni Zhabota”, në fshatin Shtupel, më banorët e fshatrave Shtupel, Kërrnicë, Binxhë, Grabc, (komunitetin joshumicë).	Datë; 04.06.2026, Ora 18:00	20 Pjesëmarrës.	17 Burra, 3 Grua.	5 komente, kërkesa apo sugjerime të regjistruara; 4 Pranohen, 1 Refuzohen.
Dëgjim Buxhetor në SHFMU “Tre Dëshmorët”, në fshatin Jashanicë, me banorët e fshatrave Jashanicë, Pogragjë, Dush i Vogël, Resnik, Jelloc, Gjurgjevik i Madh, Ujmirë, Doberdol.	Datë; 05.06.2026, Ora 17:00	20 Pjesëmarrës.	18 Burra, 2 Grua.	6 komente, kërkesa apo sugjerime të regjistruara; 4 Pranohen, 2 Refuzohen.
Dëgjim Buxhetor në SHFMU “Dëshmorët e Qëndresës”, në fshatin Gllarevë, me banorët e fshatrave Gllarevë, Sferkë, Caravik, Volljakë, Zabergjë, Përçevë.	Datë; 05.06.2026, Ora 18:00	17 Pjesëmarrës.	17 Burra, 0 Grua.	9 kërkesa apo sugjerime të regjistruara; 7 Pranohen, 2 Refuzohen,
Dëgjim Buxhetor në SHFMU “Atë Shtjefën Gjeçovi”, në fshatin Zllakuqan, më banorët e fshatrave Zllakuqan, Berkovë, Ranoc, Leskoc, Nagllavë, Dranashiq, Stupë, Rudicë, Jagodë, Videjë,	Datë; 10.06.2026, Ora 17:00	13 Pjesëmarrës.	13 Burra, 0 Gra.	6 kërkesa apo sugjerime të regjistruara; 6 Pranohen, 0 Refuzohen.

Krushevë e Madhe dhe Budisalc.				
Dëgjim Buxhetor në Sallen e koferncave Komuna Klinës kati II”, me temë “Prioritetet e grave dhe të rinjve të komunës së Klinës”.	Datë; 10.06.2026, Ora 16:00	4 Pjesëmarrës.	3 Burra, 1 Gra.	1 komente, kërkesa apo sugjerime të regjistruara. 1 Pranohen. 0 Refuzohen.
Dëgjim Buxhetor në Salla e Kuvendit Komunal Klinë, takim i përgjithshëm me banorët e Komunës së Klinës, qytetit dhe lagjeve.	Datë; 12.06.2026 Ora 10:00	18 Pjesëmarrës.	17 Burra, 1 Gra.	6 kërkesa apo sugjerime të regjistruara; 6 Pranohen, 0 Refuzohen.
Riorganizimi i Dëgjimit Buxhetor në Sallën e Konferencave, në Komunën e Klinës, me Kryetarët e Këshillave të Fshatrave.	02.06.2025 Ora 10:00	17 pjesëmarrës	0 Gra, 17 Burra.	4 kërkesa apo sugjerime të regjistruara; 4 Pranohen, 0 Refuzohen.
Publikimi në ueb-faqe / platforma.	30 ditë	0 pjesëmarrës	0 Gra, 0 Burra.	0 komente, kërkesa apo sugjerime të regjistruara nga publikimi në ueb-faqe/platforma.
Kërkesa më email të personat e caktuar.	30 ditë	0 pjesëmarrës	0 Grua, 0 Burrë.	0 kërkesa apo sugjerime të regjistruara; 0 Pranohen, 0 Refuzohen.
Kërkesa në formë fizike.	30 ditë	0 pjesëmarrës	0 Gra, 0 Burra.	0 komente, kërkesa apo sugjerime të regjistruara nga publikimi në ueb-faqe/platforma.

Kërkesa në formë fizike nga OJQ dhe Grupe Specifike.	30 ditë	0 pjesëmarrës	0 Gra, 0 vajza, dhe 0 Burra.	0 kërkesa apo sugjerime të regjistruara; 0 Pranohen, 0 Refuzohet, Adresohet.
Gjithsej;	30 ditë 29.05.2026- 16.06.2026.	152 pjesëmarrës	7 Gra, dhe 145 Burra.	51 kërkesa apo sugjerime të regjistruara; 45 Pranohen, 6 Refuzohen,

VLERËSIMI I GRUPIT PUNUES MBI KËRKESAT E QYTETARËVE

Grupi punës ka grumbulluar të gjitha kërkesat e qytetarëve dhe të njëjtat pasi i ka vendosur në dokumentin punues i ka analizuar dhe komfor standardeve të përcaktuara më lartë ka vendosur për pranimin, pranime të pjesshëm, refuzimin dhe adresimin e kërkesave. Vendimet e anëtarëve të grupit janë pasqyruar në tabelën /shtojcën nr. 5 bashkë me arsyetimet e grupit.

Shtojca nr. 2 – Tabela e detajuar me informatat për kërkesat e dhëna, arsyetimet për kërkesat e pranuar dhe të refuzuara:

Personi i kërkesës si dhe Kërkesat, Sugjerimet dhe Komentet.	Statusi i Kërkesës, Sugjerimit dhe Komenteve.	Arsyetimi (komentimi për pranimin, pjesërisht i pranueshëm dhe mospranimin të komenteve është i detyrueshëm).
DËGJIMI BUXHETOR NË SALLËN E KONFERENCAVE, NË KOMUNËN E KLINËS, ME KRYETARËT E KËSHILLAVE TË FSHATRAVE.		
Kushtrim Haliti, Kryetar i Këshillit Lokal në Jashanicë; Kërkesa ime është që të rritet buxheti për Bashkësinë Lokale të Jashanicës, pasi shuma prej 40,000 euro nuk është e	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka konstatuar se adresimi i kërkesës është në kompetencë të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë do të jetë pjesë e projeksioneve të Kornizës Afatmesme Buxhetore

mjaftueshme për realizimin e nevojave të komunitetit.”		2027-2029. Nga granti i performancës në vlerë prej 125,000 euro për fshatin Jashanicë. Grupi punues ka konstatuar së në listën e projekteve më prioritet në vitet 2027-2029, ekziston ndarja e mjeteve buxhetore, në të tre vitet, projekti më titull “Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe nëntokësore në Jashanicë-Jelloc-Resnik”
Rasim Marmullaku, Kryetar i Këshillit Lokal . Pyetja ime është nëse janë të parapara rrethojat e varrezave për fshatrat Jellovc dhe Resnik, si dhe nëse do t’u jepet prioritet disa rrugëve lokale që janë të dëmtuara	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla janë në përgjegjësi të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë do të jetë pjesë e projeksioneve të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027-2029. Grupi punues ka konstatuar së në listën e projekteve më prioritet në vitet 2027-2029, ekziston ndarja e mjeteve buxhetore, në të tre vitet, projekti më titull “Ndërtimi i rrethojave të vorrezave në Gj.Madh, Volljak, Sferkë, Jashanicë, Siqevë, Gremnik, Zajm, K.e Vogël, Shtupel, Grabanicë etj” dhe “Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe nëntokësore në Jashanicë-Jelloc-Resnik”
Mark Gojani – Kryetar i Këshillit Lokal në Budisalc Ndriçimi publik në fshatrat Budisalc, Stupë dhe Rudic ka mbetur i papërfunduar. A ka ndonjë plan për vazhdimin e këtij projekti? Gjithashtu, kërkoj që disa rrugë fushore të përfshihen në projektet komunale për shtrimin e tyre, pasi po hasim vështirësi në punimin e tokave bujqësore.”	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla janë në përgjegjësi të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë do të jetë pjesë e projeksioneve të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027-2029. Grupi punues ka konstatuar së në listën e projekteve më prioritet në vitet 2027-2029, ekziston ndarja e mjeteve buxhetore, në të tre vitet, projekti më titull “Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik në Dollc-Dresnik, Jashanicë, Drenovc, Shtupel, Klinë, Leskoc, Gremnik, Qupevë e Ulët, Siqevë, Resnik, Gj.Madh, Dush etj”
Emin Balaj nga Bashkësia Lokale e Gllarevës me fshatrat përreth. Pyetja ime ka të bëjë me gjendjen e ujësjellësit në këtë zonë.”	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla janë në përgjegjësi të komunës sa i përket ujësjellësit në bashkësinë lokale të Gllarevës, projekti ka avancuar dukshëm dhe vendosja

e gypave është realizuar në shumicën e fshatrave, pjesa e pa përfunduar do të përfshihet në vitet e ardhshme.

DËGJIMI BUXHETOR NË ODËN E FSHATIT, NË FSHATIN POTERÇ I EPËRM, MË BANORËT E FSHATRAVE POTERÇ I EPËRM, POTERÇ I POSHTËM, DRENOC DHE DUGAJEVË.

Muharrem Musa, Poterq Kërkesa ime është që jazi afër shkollës të vazhdohet deri te ura e Poterqit, pasi vërshimet po na shkaktojnë vështirësi në jetën e përditshme.”	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla janë në përgjegjësi të komunës, sa i përket kanalit afër shkollë pritet të përfshihet në projektet në vitet e ardhshme.
Ukë Manxholli, Poterq Pyetja ime është që te varrezat e dëshmorëve në fshatin Poterq të bëhet drenazhimi, sepse gjatë vërshimeve po shemben. kërkesa tjetër është që këto varreza të rrethohen	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla janë në përgjegjësi të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë do të jetë pjesë e projeksioneve të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027-2029. Grupi punues ka konstatuar së në listën e projekteve më prioritet në vitet 2027-2029, ekziston ndarja e mjeteve buxhetore, në të tre vitet, projekti më titull “Ndërtimi i rrethojave të vorrezave në Gj.Madh, Volljak, Sferkë, Jashanicë, Siqevë, Gremnik, Zajm, K.e Vogël, Shtupel, Grabanicë etj” dhe “Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe nëntokësore në Jashanicë-Jelloc-Resnik”
Ymer Ramaj, Poterq Kërkesa ime është ndërtimi i një kanali te podi i fshatit, pasi vërshimet po na shkaktojnë dëme.”	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla janë në përgjegjësi të komunës, sa i përket kanalit te podi I fshatit pritet të përfshihet në projektet në vitet e ardhshme Kemi punuar shumë në këtë drejtim dhe kemi arritur të evidentojmë shumë probleme të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore.”
Fazli Rama, Drenoc Kam disa kërkesa: 1. Zgjidhjen e çështjes së ujësjellësit në fshatin tonë;	1. Pranohet 2. Pranohet 3. Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla janë në përgjegjësi të komunës: 1. Sa i përket ujësjellësit në fshatin tuaj, për vitin 2027 janë paraparë mbi 50 mije euro sipas

2. Shtrimin me zhavor të rreth 1500 metrave rrugë fushore; 3. Ndërtimin e 30 metrave kanal me gypa të mbyllur.”		projektit “Ndërtimi i ujësjellësit në Drenovcë - Poterqi i Poshtëm-Dugajevë-Zajmë” 2. Shtrimi I rrugëve me zhavor pritët të realizohet sipas mundësive buxhetore nga kategoria ekonomike Mallëra dhe shërbime 3. Sa i përket gypave të mbyllur në fshatin tuaj parashihet t’I bashkëngjitet projektit “Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe infrastrukturës nëntokësore Poterq- Dugajevë-Drenovcë”
Bedri Rama, Drenoc “Pyetja ime është që në lagjen tonë kemi nevojë për rreth 2500 metra trotuar.”	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla janë në përgjegjësi të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë do të jetë pjesë e projeksioneve të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027-2029. Grupi punues ka konstatuar së në listën e projekteve më prioritet në vitet 2027-2029, ekziston ndarja e mjeteve buxhetore, në të tre vitet, projekti më titull “Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe infrastrukturës nëntokësore Poterq- Dugajevë-Drenovcë”
Shaqir Fejza, Drenoc Kam dy kërkesa: -Ndërtimin e parkut të fshatit te lapidari; -Rreth 30 metra kanalizim.”	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla janë në përgjegjësi të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë do të jetë pjesë e projeksioneve të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027-2029. 1. Ndërtimin e parkut të fshatit te lapidari pritët të përfshihet në projektin “Zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbruara (Parqeve) në Këpuz, Shtupel, Zllakuqan, Gremnik, Volljak, Jashanicë, Klinë etj” 2. Rreth 30 metra kanalizim pritët të përfshihet në projektin “Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe infrastrukturës nëntokësore Poterq- Dugajevë-Drenovcë”

DËGJIMI BUXHETOR NË SHFMU “AZEM BEJTA”, NË FSHATIN GRABANICË, MË BANORËT E FSHATRAVE GRABANICË, DOLLOVË, BOKSHIQ, KËPUZ DHE QESKOVË.

Nuk ka pyetje dhe kërkesa	/	/
Nuk ka pyetje dhe kërkesa	/	/
DËGJIMI BUXHETOR NË SHFMU “MOTRAT QIRIAZI”, NË FSHATIN ZAJM, MË BANORËT E FSHATRAVE ZAJM, GREMNIK, DEIQ, DOLLC DHE DRESNIK.		
Xhafer Gashi (Zajm): Kërkesa ime është që të na shtrohet me asfalt një rrugicë në fshatin tonë."	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla janë në përgjegjësi të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë do të jetë pjesë e projeksioneve të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027-2029. Grupi punues ka konstatuar së në listën e projekteve më prioritet në vitet 2027-2029, ekziston ndarja e mjeteve buxhetore, në të tre vitet, projekti më titull “Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe nëntokësore në Zajmë-Deiq”
Lek Frroku (Dollc): Kam një kërkesë për fshatin tim. 1. Kemi probleme me rrjetin elektrik, me shtylla të vjetra dhe tela të energjisë elektrike që pothuajse prekin tokën, gjë që paraqet rrezik për banorët. 2. Gjithashtu, kemi nevojë për sistem kanalizimi."	1. Refuzohet 2. Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla janë pjesërisht në përgjegjësi të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë do të jetë pjesë e projeksioneve të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027-2029. 1. Grupi punues ka konstatuar se mirëmbajtja e tensionit të lartë nuk është përgjegjësi e komunës dhe kërkesa nuk mund të përfshihet në Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027-2029. Kjo kërkesë i adresohet Kompanisë Kosovare për Distributim të Energjisë Elektrike – KEDS, pasi komuna e Klinës nuk ka kompetenca për të intervenuar në sistem të tillë dhe KEDS është përgjegjëse për rrjetin e energjisë elektrike. 2. Grupi punues ka konstatuar së në listën e projekteve më prioritet në vitet 2027-2029, ekziston ndarja e mjeteve buxhetore, në të tre vitet, projekti më titull “Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe nëntokësore në Zajmë-Deiq”
Kristjan Hajdari (Deiq):	Pranohet	Përgjigja:

Kërkesa ime është që të parashihet në buxhet zgjerimi i kanalit që lidhet me lumin Drin, pasi gjatë vërshimeve uji po na dëmton tokat bujqësore dhe pronat familjare."		Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla janë në përgjegjësi të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë do të jetë pjesë e projeksioneve të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027-2029. Grupi punues ka konstatuar së në listën e projekteve më prioritet në vitet 2027-2029, ekziston ndarja e mjeteve buxhetore, në të tre vitet, projekti më titull "Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe nëntokësore në Zajmë-Deiq"
Tun Dedaj (Deiq): Kam vetëm një kërkesë: a ka ndonjë plan për rrethimin e varrezave të fshatit tonë?	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla janë në përgjegjësi të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë do të jetë pjesë e projeksioneve të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027-2029. Grupi punues ka konstatuar së në listën e projekteve më prioritet në vitet 2027-2029, ekziston ndarja e mjeteve buxhetore, në të tre vitet, projekti më titull "Ndërtimi i rrethojave të varrezave në Gj.Madh, Volljak, Sferkë, Jashanicë, Siqevë, Gremnik, Zajm, K.e Vogël, Shtupel, Grabanicë etj"
Tom Marku (Deiq): "Pyetja ime është: a do të shtrohet rruga kryesore Deiq-Zajm, nga Ura e Haxhisë deri te pompa Kastrati?"	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla janë në përgjegjësi të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë do të jetë pjesë e projeksioneve të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027-2029. Grupi punues ka konstatuar së në listën e projekteve më prioritet në vitet 2027-2029, ekziston ndarja e mjeteve buxhetore, në të tre vitet, projekti më titull "Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe nëntokësore në Zajmë-Deiq"

DËGJIMI BUXHETOR NË SHFMU "AVNI ZHABOTA", NË FSHATIN SHTUPEL, MË BANORËT E FSHATRAVE SHTUPEL, KËRRNICË, BINXHË, GRABC, (KOMUNITETIN JOSHUMICË).

Muhamet Dauti (Shtupel): Kërkesa ime është që disa rrugë në fshatin tonë kanë mbetur pa emërtime.	Refuzohet	Përgjigja: Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla nuk janë në përgjegjësi të komunës komuna ka themeluar Komisionin për Emërtimin e Rrugëve. Aty duhet t'i adresoni kërkesat tuaja. Komisioni i shqyrton dhe i dërgon në Ministrinë e Pushtetit Lokal për aprovim
Kujtim Temaj (Shtupel): Kërkesa ime për ju është që kemi një rrugicë të shkurtër, rreth 50 metra, e cila ka nevojë të shtrohet me asfalt.	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla janë në përgjegjësi të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë do të jetë pjesë e projeksioneve të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027-2029. Grupi punues ka konstatuar së në listën e projekteve më prioritet në vitet 2027-2029, ekziston ndarja e mjeteve buxhetore, në të tre vitet, projekti më titull “Ndërtimi i rrugëve dhe kanalizimit në Shtupel-Kërrnicë-Binxhe-Gracp”
Magjun Fejzullahu (Shtupel):Kërkesa ime është që të na shtrohen rreth 2,000 metra rrugë fushore me zhavor, pasi kemi vështirësi në punimin e tokave. Gjithashtu, kemi një rrugë në fshatin tonë që është bërë e pakalueshme, pasi dy vetura kanë vështirësi të kalojnë njëra pranë tjetrës për shkak të degëve dhe barishtave që ka dalë përgjatë saj.	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla janë në përgjegjësi të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë do të jetë pjesë e projeksioneve të Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitet e ardhshme. Shtrimi I rrugëve me zhavor pritët të realizohet sipas mundësive buxhetore nga kategoria ekonomike Mallëra dhe shërbime
Faruk Dauti (Shtupel): Kam vetëm një kërkesë: të vendosen disa pengesa të shpejtësisë (policë të shtrirë prej gome) në asfalt, për shkak të shpejtësisë së automjeteve që paraqesin rrezik për banorët e fshatit.	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se kërkesa në fjalë është e realizuar pas dëgjimit buxhetor Drejtoria e Inspektoratit ka vendosur policin e shtrirë prej gomës afër shkollës në fshatin Shtupel.

Samir Demaj (Shtupel): Kryetar, a ka ndonjë projekt për furnizimin me ujë të pijshëm në fshatin tonë?	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla janë në përgjegjësi të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë do të jetë pjesë e projeksioneve të Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitet e ardhshme.
DËGJIMI BUXHETOR NË SHFMU “TRE DËSHMORËT”, NË FSHATIN JASHANICË, ME BANORËT E FSHATRAVE JASHANICË, POGRAGJË, DUSH I VOGËL, RESNIK, JELLOC, GJURGJEVIK I MADH, UJMIRË, DOBERDOL.		
Aziz Bajraktari (Resnik): Kërkesa ime është për 70 metra kanalizim.	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla janë në përgjegjësi të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë do të jetë pjesë e projeksioneve të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027-2029. Grupi punues ka konstatuar së në listën e projekteve më prioritet në vitet 2027-2029, ekziston ndarja e mjeteve buxhetore, në të tre vitet, projekti më titull “Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe nëntokësore në Jashanicë-Jelloc-Resnik”
Skender Desku (Jelloc): Pyetja ime, Kryetar, për ju është se kemi nevojë për 100 metra kanalizim.	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla janë në përgjegjësi të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë do të jetë pjesë e projeksioneve të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027-2029. Grupi punues ka konstatuar së në listën e projekteve më prioritet në vitet 2027-2029, ekziston ndarja e mjeteve buxhetore, në të tre vitet, projekti më titull “Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe nëntokësore në Jashanicë-Jelloc-Resnik”
Tahir Berisha (Gjurgjevik i Madh): Rruga kryesore është mbuluar prej lisave dhe degëve që na vështirësojnë kalimin ose	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla janë në përgjegjësi të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për këto shërbime të

shpërndarjen me dy vetura, dhe kërkesa tjetër është se kemi diku 500 metra rrugë fushore që na nevojiten me i shtruar me zhavor.		tilla do të jenë pjesë e projeksioneve të Kornizës Afatmesme Buxhetore për 2027-2029.
Mark Toplanaj (Pograxh): Përshëndetje, Kryetar dhe të pranishëm. Deshta t'i ndaj disa shqetësime me ju. Kur pati vërshime, më janë dëmtuar diku 2 hektarë tokë bujqësore dhe a ka ndonjë përgjigje për këtë problem. E dyta është se kemi problem me telat e rrymës edhe me shtyllat elektrike në fshatin tonë. Kam edhe një kërkesë për 80 metra kanalizim.	1. Refuzohet 2. Refuzohet 3. Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla janë pjesërisht në përgjegjësi të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë do të jetë pjesë e projeksioneve të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027-2029. 1. Grupi punues ka konstatuar se dëmet nga vërshimet janë përgjegjësi e nivelit qendror. 2. Grupi punues ka konstatuar se mirëmbajtja e tensionit të lartë nuk është përgjegjësi e komunës dhe kërkesa nuk mund të përfshihet në Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027-2029. Kjo kërkesë i adresohet Kompanisë Kosovare për Distributim të Energjisë Elektrike – KEDS, pasi komuna e Klinës nuk ka kompetenca për të intervenuar në sistem të tillë dhe KEDS është përgjegjëse për rrjetin e energjisë elektrike. 3. Grupi punues ka konstatuar se në listën e projekteve më prioritet në vitet 2027-2029, planifikohet t'i bashkëngjitet projektit me titull “Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe nëntokësore në Jashanicë-Jelloç-Resnik”
DËGJIMI BUXHETOR NË SHFMU “DËSHMORËT E QËNDRESËS”, NË FSHATIN GLLAREVË, ME BANORËT E FSHATRAVE GLLAREVË, SFERKË, CARAVIK, VOLLJAKË, ZABERGJË, PËRÇEVË.		

Amrush Hasanaj (Gllarevë) Kërkesa ime është që të planifikoni në projektet komunale ndërtimin e një parku në fshatin tonë.	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla janë në përgjegjësi të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë do të jetë pjesë e projeksioneve të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027-2029. Grupi punues ka konstatuar së në listën e projekteve më prioritet në vitet 2027-2029, ekziston ndarja e mjeteve buxhetore, në të tre vitet, projekti më titull “Zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbruara (Parqeve) në Këpuz, Shtupel, Zllakuqan, Gremnik, Volljak, Jashanicë, Klinë etj”
Pajazit Veselaj (Gllarevë) Kryetar, jemi dy familje që ende nuk kemi të përfunduar rrjetin e kanalizimit. Bëhet fjalë për rreth 100 metra kanalizim. Nuk është urgjente, por dëshirojmë të dimë nëse do të përfshihet në projektet e ardhshme dhe nëse mund të përfundohet brenda tre viteve të ardhshme.	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla janë në përgjegjësi të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë do të jetë pjesë e projeksioneve të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027-2029. Grupi punues ka konstatuar së në listën e projekteve më prioritet në vitet 2027-2029, ekziston ndarja e mjeteve buxhetore, në të tre vitet, projekti më titull “Ndërtimi i infrastruktures nentokesore dhe mbitokësore Gllareve-Rixheve-Stapanice-Zabergje”
Asllan Haxhaj (Gllarevë) Pyetje: Si banor i fshatit Gllarevë kam kërkesa: Në lagjen tonë janë vendosur shtyllat elektrike, por kabllot ende nuk janë shtrirë, pavarësisht kërkesave të shumta drejtuar KEDS-it. Te oborri i Januz Haxhajt ndodhet një shtyllë elektrike e vendosur në hyrje të oborrit, e cila nuk është larguar nga KEDS-i. Në lagjen e Hasanjve deri te Haxhajt, telat e rrymës prekin	Refuzohet	Përgjigja: Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla nuk janë në përgjegjësi të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë nuk mundet të jetë pjesë e projeksioneve të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027-2029. Grupi punues ka konstatuar se mirëmbajtja e tensionit të lartë nuk është përgjegjësi e komunës dhe kërkesa nuk mund të përfshihet në Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027-2029. Kjo kërkesë i adresohet Kompanisë Kosovare për Distributim të Energjisë Elektrike – KEDS, pasi komuna e Klinës nuk ka kompetenca për të intervenuar në sistem të tillë dhe KEDS është përgjegjëse për rrjetin e energjisë elektrike.

tokën dhe shtyllat janë në gjendje të dobët.		
Haki Morina (Rixhevë) Pyetje: Përshëndetje, Kryetar dhe të pranishëm. Kam një kërkesë për shtrimin me zhavor të një rruge fushore me gjatësi rreth 1,000 metra.	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla janë në përgjegjësi të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë do të jetë pjesë e projeksioneve të Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitet 2027-2029.
Fadil Bashota (Cerovikë) Kam disa kërkesa që dëshiroj t'i paraqes dhe shpresoj që të përfshihen në projektet komunale: 1.Ndërtimi i trotuarit në fshatin Cerovikë, 2. Vendosja e ndriçimit publik 3. Pastrimi i dy deponive ilegale të mbeturinave 4. Shtrimi me zhavor i rreth 1,500 metrave rrugë fushore, 5. Angazhimi i një mësuesi mbështetës për tre nxënës me aftësi të kufizuara që vijnë në mësimin në shkollën e fshatit	1. Pranohet 2. Pranohet 3. Refuzohet 4. Pranohet 5. Pranohet	Përgjigja: - Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla janë në përgjegjësi të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë është i aprovuar në vitin 2026. - Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla janë në përgjegjësi të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë do të jetë pjesë e projeksioneve të Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitet 2027-2029 sipas projektit “Ndërtimi i infrastrukturës mbitorësore dhe nëntokësore Cerovik-Qabiq-Dobërdol” - Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla nuk janë në përgjegjësi të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë nuk mundet të jetë pjesë e projeksioneve të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027-2029. - Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla janë në përgjegjësi të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë do të jetë pjesë e projeksioneve të Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitet e ardhshme. - Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla janë në përgjegjësi të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për angazhimin e mësimdhënësve është e paraparë me Rregulloren Të Granitit Specifik të Arsimit

**DËGJIMI BUXHETOR NË SHFMU “ATË SHTJEFËN GJEÇOVI”, NË FSHATIN ZLLAKUQAN, MË
BANORËT E FSHATRAVE ZLLAKUQAN, BERKOVË, RANOC, LESKOC, NAGLLAVË,
DRANASHIQ, STUPË, RUDICË, JAGODË, VIDEJË, KRUSHEVË E MADHE DHE BUDISALC.**

Frrok Tanushi (Berkovë) Ujërat e zeza për fshatin Berkovë, ndriçimi publik dhe trotuari – a i keni në projekte?	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla janë në përgjegjësi të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë do të jetë pjesë e projeksioneve të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027-2029. Grupi punues ka konstatuar së në listën e projekteve më prioritet në vitet 2027-2029, ekziston ndarja e mjeteve buxhetore, në të tre vitet, projekti më titull “Ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujrave të zeza në Ranoc, Radulloc, Shtupel, Shtaricë etj” dhe projekti “Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik në Dollc-Dresnik, Jashanicë, Drenovc, Shtupel, Klinë, Leskoc, Gremnik, Qupevë e Ulët, Siqevë, Resnik, Gj.Madh, Dush etj”
Mark Gojani (Budisalc) Kam disa kërkesa: 1. Ndërtimin e një ure, betonizimin e 1200 metrave kanal të ujitjes në Rudicë, një rrugë te varrezat e komuniteteve, 200 metra rrugë në Stup dhe 200 metra në Rudicë, trotuarin Budisalc–Rudicë, rrugë fushore me zhavor dhe rregullimin e rrethojave te varrezat në Budisalc.	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla janë në përgjegjësi të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë do të jetë pjesë e projeksioneve të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027-2029. Grupi punues ka konstatuar së në listën e projekteve më prioritet në vitet 2027-2029, ekziston ndarja e mjeteve buxhetore, në të tre vitet, projekti më titull “Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe urës në Budisalcë-Rudicë”; Projekti “Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik në Dollc-Dresnik, Jashanicë, Drenovc, Shtupel, Klinë, Leskoc, Gremnik, Qupevë e Ulët, Siqevë, Resnik, Gj.Madh, Dush etj” dhe projekti “Ndërtimi i rrethojave të vorrezave në Gj.Madh, Volljak, Sferkë, Jashanicë, Siqevë, Gremnik, Zajm, K.e Vogël, Shtupel, Grabanicë etj”
Simon Perlaska (Zllakuqan) Na nevojiten 600 metra kanalizim në fshatin tonë. Gjithashtu, ka disa rrugë fushore të pakalueshme, të cilat po e vështirësojnë punën në bujqësi. A ka mundësi të shtrohen me zhavor	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla janë në përgjegjësi të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë do të jetë pjesë e projeksioneve të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027-2029. Grupi punues ka konstatuar së në listën e projekteve më prioritet në vitet 2027-2029, ekziston ndarja e

		mjeteve buxhetore, në të tre vitet, projekti më titull “Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe infrastrukturës nëntokësore Zllakuqan-Pataqan-Berkove, Krushevë e Vogël”, ndërsa shtrimi i rrugëve me zhavor pritët të realizohet nga buxheti kategoria Mallera dhe sherbime.
Lush Ndrecaj (Krushevë e Madhe) Kam tri kërkesa për fshatin tonë: 1. Rrethimin e varrezave, 2. Një kanal për ujitjen e tokave bujqësore dhe 3. Ndërtimin e trotuarit.	1. Pranohet 2. Pranohet 3. Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla janë në përgjegjësi të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë do të jetë pjesë e projeksioneve të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027-2029. 1. Grupi punues ka konstatuar së në listën e projekteve më prioritet në vitet 2027-2029, ekziston ndarja e mjeteve buxhetore, në të tre vitet, projekti më titull “Ndërtimi i rrethojave të vorrezave në Gj.Madh, Volljak, Sferkë, Jashanicë, Siqevë, Gremnik, Zajm, K.e Vogël, Shtupel, Grabanicë etj” 2. Grupi punues ka konstatuar së në listën e projekteve më prioritet në vitet 2027-2029, ekziston ndarja e mjeteve buxhetore, në të tre vitet, projekti më titull “Ndërtimi i kanaleve të ujitjes në Rudicë-Stupë-Videjë- Zajm,Potërq-Dollovë, Volljakë-Këpuz etj” 3. Grupi punues ka konstatuar së në listën e projekteve më prioritet në vitet 2027-2029, ekziston ndarja e mjeteve buxhetore, në të tre vitet, projekti më titull “Ndërtimi i infrastrukturës mbitokësore dhe infrastrukturës nëntokësore Zllakuqan-Pataqan-Berkove, Krushevë e Vogël”

DËGJIMI BUXHETOR NË SHTËPINË E KULTURËS “JEHONA E DUKAGJINIT”, ME TEMË “PRIORITETET E GRAVE DHE TË RINJVE TË KOMUNËS SË KLINËS”.

Rajmond Nocaj Kërkesa ime është që të na mundësohet një hapësirë apo lokal për studentët e Komunës së Klinës, ku të mund të zhvillojmë aktivitetet tona studentore. Kërkojmë që kjo hapësirë të jetë në dispozicion gjatë periudhës sezonale prej	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla janë në përgjegjësi të komunës dhe ka dhënë përgjigje sipas kërkesës komuna do t’iu ofrojë hapësirën e nevojshme për studentët.
---	-----------------	---

rreth tre muajsh, në mënyrë që të organizojmë takime, aktivitete edukative, kulturore dhe projekte të ndryshme në interes të studentëve, faleminderit.		
DËGJIMI BUXHETOR NË SALLA E KUVENDIT KOMUNAL KLINË, TAKIM I PËRGJITHSHËM ME BANORËT E KOMUNËS SË KLINËS, QYTETIT DHE LAGJEVE.		
Naim Musliu (Klinë) Ai kërkoi nga Komuna që të planifikojë dhe të hartojë një projekt afatgjatë për furnizimin me ujë të pijshëm, në mënyrë që qytetarët të mos përballen me probleme të vazhdueshme në këtë shërbim jetik Po ashtu, ai propozoi që disa nga projektet e parapara për periudhën 2027–2029 të shqyrtohen për mundësinë e realizimit më të hershëm, me qëllim që të përfundojnë sa më shpejt dhe të jenë në shërbim të qytetarëve. Lidhur me arsimin, Musliu kërkoi që Drejtoria e Arsimit të ndajë më shumë mjete buxhetore për pajisjen e shkollave me tabela të mençura, duke vlerësuar se kjo do t'u mundësonte mësimdhënësve kushte më të mira pune dhe do të ndikonte pozitivisht në ngritjen e cilësisë së arsimit. Ai gjithashtu theksoi se obligimet që rrjedhin nga Kontrata Kolektive duhet të planifikohen me kohë në buxhet, në mënyrë që të shmangen kostot shtesë që	Pranohet	Përgjigja: Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se disa nga kërkesat e parashtruara janë shërbime të cilat janë në përgjegjësi të komunës, ndërsa disa nga kërkesat eparashtruara nuk janë në përgjegjësinë e komunës. Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se kërkesat që janë në përgjegjësi të komunës: 1. Projekti afatgjatë për furnizimin me ujë të pijshëm është projekt i madhe dhe komuna parasheh të jetë pjesë e projeksioneve të Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitet e ardhshme. 2. Sa i përket kërkesës që disa nga projektet e parapara për periudhën 2027–2029 të shqyrtohen për mundësinë e realizimit më të hershëm konfirmojmë se projektet realizohen konformë buxhetit të lejuar nga Niveli qendror. 3. Lidhur me kërkesën për ndarjen e më shumë mjeteve në Drejtorinë e Arsimit për pajisjen e shkollave me tabela të mençura për shkak të vështirësive buxhetore si arsye e obligime që rrjedhin nga kontrata kolektive komunës po I pamundësohet realizimi I projekteve në përmasa më të mëdha. Grupi punues ka konstatuar se në listën e projekteve më prioritet në vitet 2027-2029, ekziston ndarja e mjeteve buxhetore, në të tre vitet, projekti me titull “Furnizim me tabela të mençura në shkollë në Çabiq, Ujmirë, Ismet Rraci, Motrat Qiriaz, Fehmi Agani, Luigj Gurakuqi etj” 4. Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se lidhur me planifikimin e obligimeve që rrjedhin nga kontrata kolektive komuna nuk mund të planifikojë buxhet mbi kufijt e qarkores buxhetore 2027-02.

krijohen nga procedurat përmbartimore. Në emër të banorëve, Musliu paraqiti edhe kërkesën për rregullimin e rrugës që shpie drejt qytetit Antik, si një projekt me rëndësi për zhvillimin lokal dhe promovimin e trashëgimisë kulturore. Po ashtu, ai propozoi ndërtimin e një unaze rrugore në dalje të qytetit, e cila do të lidhej me fshatrat përreth, përfshirë Budisalcin dhe vendbanime të tjera, me qëllim të përmirësimit të infrastrukturës rrugore dhe lehtësimit të qarkullimit të qytetarëve.		5. Grupi punues ka konstatuar së në listën e projekteve më prioritet në vitet 2027-2029, ekziston ndarja e mjeteve buxhetore, në të tre vitet, projekti më titull “Ndërtimi i rrugëve dhe segmenteve të tyre Malë Bashota, Dositej Obradoviq, Bekim Fehmiu, Heronjtë e Kombit dhe infrastruktures nëntokësore në Klinë-Dersnik-Dollc” 6. Grupi punues ka diskutuar dhe ka konstatuar se shërbime të tilla janë në përgjegjësi të komunës dhe ka dhënë përgjigje se ndarja e buxhetit për një projekt të tillë do të jetë pjesë e projeksioneve të Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitet e ardhshme.
---	--	--

Shtojca nr. 3 – Tabela e detajuar me informatat për kërkesat e dhëna, arsyetimet për kërkesat e pranuar dhe të refuzuara në web faqe dhe platforma online:

Personi i kërkesës si dhe Kërkesat, Sugjerimet dhe Komentet.	Statusi i Kërkesës, Sugjerimit dhe Komenteve.	Arsyetimi (komentimi për pranimin, pjesërisht i pranueshëm dhe mospranimin të komenteve është i detyrueshëm).
PUBLIKIMI NË UEB-FAQE / PLATFORMA.		

0 pjesëmarrës.	0 komente, kërkesa apo sugjerime të regjistruara.	Grupi punues nuk ka pranuar asnjë koment/sugjerim apo kërkesë nga publikimi në ueb-faqe/platforma, pasi platforma e-konsultimet ka qenë jashtë funksionit.
----------------	---	--

Shtojca nr. 4 – Tabela e detajuar me informatat për kërkesat e pranuarat më email:

Personi i kërkesës si dhe Kërkesat, Sugjerimet dhe Komentet.	Statusi i Kërkesës, Sugjerimit dhe Komenteve.	Arsyetimi (komentimi për pranimin, pjesërisht i pranueshëm dhe mospranimin të komenteve është i detyrueshëm).
KËRKESA MË EMAIL TË PERSONAT E CAKTUAR.		
	0 komente, kërkesa apo sugjerime të regjistruara.	

Shtojca nr. 5 – Tabela e detajuar me informatat për kërkesat e pranuarat në formë fizike:

Personi i kërkesës si dhe Kërkesat, Sugjerimet dhe Komentet.	Statusi i Kërkesës, Sugjerimit dhe Komenteve.	Arsyetimi (komentimi për pranimin, pjesërisht i pranueshëm dhe mospranimin të komenteve është i detyrueshëm).
KËRKESA NË FORMË FIZIKE.		
	0 komente, kërkesa apo sugjerime të regjistruara.	

Shtojca nr. 6 – Tabela e detajuar me informatat për kërkesat e pranuarat në formë fizike nga OJQ dhe grupe tjera specifike:

Personi i kërkesës si dhe Kërkesat, Sugjerimet dhe Komentet.	Statusi i Kërkesës, Sugjerimit dhe Komenteve.	Arsyetimi (komentimi për pranimin, pjesërisht i pranueshëm dhe mospranimin të komenteve është i detyrueshëm).
KËRKESA NË FORMË FIZIKE NGA OJQ DHE GRUPE SPECIFIKE.		

	0 komente, kërkesa apo sugjerime të regjistruara.	Përgjigja: Grupi punues ka vlerësuar se kërkesa është në kompetencë të komunës.
--	--	---

Komuna e Klinës ka vazhduar të demonstrojë përkushtim të lartë në garantimin e një procesi buxhetor të hapur, transparent, gjithëpërfshirës dhe të qasshëm për të gjithë qytetarët. Në kuadër të hartimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB), organizimi i dëgjimeve publike ka shërbyer si një mekanizëm i rëndësishëm për përfshirjen aktive të qytetarëve dhe grupeve të interesit në procesin e planifikimit dhe priorizimit të financave publike komunale.

Duke njohur rëndësinë e pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje, Komuna ka synuar të sigurojë transparencë të plotë gjatë të gjitha fazave të procesit buxhetor. Në këtë drejtim, dokumentacioni përkatës është publikuar me kohë, ndërsa informacioni është komunikuar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme për qytetarët, me qëllim të lehtësimit të pjesëmarrjes së tyre të informuar. Për të rritur qasjen dhe përfshirjen e sa më shumë qytetarëve, Komuna ka aplikuar një qasje fleksibile në organizimin e dëgjimeve buxhetore. Takimet janë zhvilluar në forma të ndryshme, duke kombinuar pjesëmarrjen fizike dhe atë virtuale, si dhe duke u organizuar në lokacione të ndryshme brenda territorit të komunës. Kjo ka mundësuar që qytetarët nga komunitete dhe zona të ndryshme të kenë mundësi të barabarta për të paraqitur nevojat, propozimet dhe rekomandimet e tyre lidhur me planifikimin buxhetor. Përmes këtij procesi, Komuna e Klinës ka forcuar dialogun me qytetarët dhe ka kontribuar në ndërtimin e një qeverisjeje më transparente, më llogaridhënëse dhe më të orientuar drejt nevojave reale të komunitetit.

Zyrtari përgjegjës për konsultim publik, anëtar i grupit punues,

Egzon Sejdiu

Klinë, 23.06.2026

